



## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË<sup>1</sup>, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

### PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

N.N.T.SH. "Drini Company"Sh.p.k. – Prizren, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

**Mirembajtja dimerore dhe verore e rrugeve lokale ne teritorin e - K.K. Dragashit ( 24 muaj)**

me numër identifikues: 621-18-7071-2-2-1( nr, i jashtem) dhe m me nr, te mbrendshem 621-2018-103-221.

#### Neni 1              Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

**Mirembajtja dimerore dhe verore e rrugeve lokale ne teritorin e - K.K. Dragashit ( 24 muaj)**

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendorur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.l.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me [05.11.2018] dhe përfundon në datën [05.11.2020]

#### Neni 2              Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve **do të jetë i dhene sipas specifikacionit(fshatrat) ne tere teritorin e K.K. Dragash**

[Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese shënoj]

[Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

<sup>1</sup> Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

REPUBLICA  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash  
03 Nr. Br. 400-24583  
05.11.2018  
Dragash - Dragash



### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve, *Qmimi i ofruar sipas kriterit te “qmimi me i lire i poentuar (3,746.88) Euro*

Vlera totale indikative e kontratës është [120,000.00 ] Euro.

Pagesat do te behen **me dorezimin e nje raporti mbi realizimin e sherbimeve te nenshkruar nga ana e menagjerit te kontrates.**

**Vërejtje!**

Sipas nenit 38,paragrafit 2 te LPP n.04/L-042 i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin NR.04/L-237 Ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, në momentin kur sasia/vlera e parapare per kete periudhe hargjohet (+/- 30 % mosperputhje e lejuar ) pa marre parasysh daten origjinale te skadimit te kontrates,kontrata do te nderpritet automatikisht.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[sheno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.



5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet [Angleze] [Shqipe] [Serbe]<sup>2</sup> në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuro Ismaili <i>103</i>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2018
Vula:	

#### Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	N.N.T.SH. " Drini Company" Prizren
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2018
Vula:	



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.



## PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroresit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroresit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroresit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrore i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofroesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofroesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroresit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofroresit të Shërbimeve siguruesve të Ofroresit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroresit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### Neni 4 Nën-kontraktimi





4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofrofresi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofrofresi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofrofresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditës pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofrofresi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofrofresi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofrofresit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofrofresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5                   Tatimi

5.1 Ofrofresi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përpunje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofrofresi i Shërbimeve.

#### Neni 6                   Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofrofresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofrofresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofrofresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

#### Neni 7                   Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofrofresi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrofresi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshtës ndërmjet ofrofresit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofrofresit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofrofresin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8                   Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë **madhore** që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.



8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitet, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.



9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofreusin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofreusi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofreusi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofreusi i Shërbimeve

10.1 Ofreusi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofreusit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofreusi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofreusit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofreusin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofreusit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofreusit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofreusi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofreus i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofreusi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe t'i veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe t'i veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofreusi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të



ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitetë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

#### Neni 12            **Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13            **Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhëni e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale,



ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, tē garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin pér sjellje tē keqe tē Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe tē konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, tē garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe nē këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do tē ketë tē drejtë pér kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do tē jetë i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur tē Operatorëve Ekonomik tē kontratës publike kornizë.

**Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i sherbimeve do tē, jo më vonë se dita e nënshkrimit tē kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pér ekzekutim tē plotë dhe tē mire tē kontratës. Shuma e sigurisë do tē saktësohet nē KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pér çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit tē plotë dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit tē Shërbimeve.

14.2 Garancioni do tē vazhdojë tē mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit tē Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit tē kontratës do tē jetë nē formatin e dhënë nē Pjesën IV tē kësaj kontrate.

**Neni 15      Sigurimi që do tē merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do tē marr dhe do tē ruaj, dhe do tē shkaktoj Nënkontraktorët tē marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por nē bazë tē kushteve tē miratara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe pér mbulim, siç do tē specifikohet nē KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë tē Autoritetit Kontraktues, do tē ofroj dëshmi pér Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

**Neni 16      Parimet tē përgjithshme tē pagesave**

16.1 Pagesat do tē bëhen nē Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do tē bëhen nē llogarinë bankare tē dhënë nē Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjetet kërkesës pér pagesë, duhet tē përdoret pér t'i raportuar ndryshimet nē llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet tē paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data nē tē cilën kërkesa e pranueshme pér pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do tē jetë data nē tē cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa pér pagesë nuk do tē jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund tē pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa pér pagesë nuk mund tē plotësohet sepse shuma nuk do tē paguhet pér shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund tē mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund tē bëhet një inspektim i menjëhershëm pér qëllim tē kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do tē japë sqarime, modifikime apo informata tē tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do tē llogaritet nga data nē tē cilën është regjistruar kërkesa pér pagesë e përgatitur nē mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që tē ketë kaluar afati i fundit i dhënë nē Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, tē kérkojë interesin pér pagesë tē vonuar me normë tē re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës nē ditën e parë tē muajit nē tē cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë tē përqindjes. Interesi pér pagesë tē vonuar do tē zbatohet pér kohën që kalon ndërmjet datës së afatit tē fundit tē pagesës (nuk përfshihet) dhe datës nē tē cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).



16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jepin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### Neni 17                    Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkijnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

#### Neni 18                    Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç pëershruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19                    Konsekuenca e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/apo
- ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20                    Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.



20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 21      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**Neni 22    Dëmshpërbllimi**

22.1 Ofrojës i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoresh, punonjësit dhe agentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofrojës së shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofrojës te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofrojësi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofrojësi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë



### PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kur sive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Gjuha shqipe</b>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i mbikëqyrjes së shërbimeve do të jetë <b>Mursel Halili</b>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vleres indikative ose 12,000 €, per periudhen 25 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.</b>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	<p>Reziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <i>[shëno shumen]</i></li> <li>b) Përgjegjësia e pales së tretë <i>[shëno shumen]</i></li> <li>c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve <i>[shëno shumen]</i></li> <li>d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumen]</i></li> <li>e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve <i>[shëno shumen]</i></li> </ul>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <b>Inspektimi i shërbimeve behet nga menaxheri i caktuar nga Autoriteti Kontraktues</b> Periudha e përgjegjësise së Defekteve është <i>[shëno daten]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>[Specifikanzi departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p><i>[shëno te dyja]</i></p> <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>Gjykata Themelore ne Prizren dega ne Dragash</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njoitura ndërkombëtarisht)].</i></p>

## DEKLARATA E GARANTUESIT

Sigurim Ekzekutimi



Serial 070030060008123

Për **KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

**DUKE PASUR PARASYSH QË****N.N.T.SH. "Drini Company" Sh.p.k.**

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër te lëshoj një sigurim te realizimit lidhur me kontratën me titull

**AJTJA DIMERORE DHE VERORE E RRUGEVE LOKALE NE TERITORIN E KOMUNES SE DRAGASHIT**

të dhënë me numrin e Prokurimit.

**621-18-7071-2-2-1**

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** Operatori Ekonomik dëshiron të lëshoje një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:**PËR KËTO ARSYE** vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej**€ 12,000.00****Dymbetdhjete mijë €**

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik përfshirë kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme përmes realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

**€ 12,000.00**

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen

(shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

**05.11.2018**

deri më

**05.12.2020**

Lëshuar në

**PRIZREN**dato<sup>re</sup> **02.11.2018**

Nënshkrimi dhe Vizata e Garantuesit

**PRIZREN**

0003138

# Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve lokale - K.K. Dragash

A	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Totali ( 60 % e pikeve per vleresim)
a	A. RRUGA REGJIONALE DRAGASH – RESTELICE (R113) - R113-Qendra e fshatit – Gjatesia km				
1	Pastrimi i rruges nga bora nga ura e fshatit deri në qendrën e fshatit Mlik - 1.3km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
2	Pastrimi i rruges nga bora nga rruga kryesore deri ne fshatin Vraniq 0.9km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
3	Rruga kryesore - Orqushe 2.9km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
4	BUKA - kufi ( Borje) 1.33km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
5	BUKA - Glloboqicë - 2km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
6	Glloboqica-Zlipotok - 4.00km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
7	Krushevë - pika kufitare Shishtavec 3.3 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
8	Qendra e fshatit Krushevë- 1.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
9	Krushev-Zlipotok - 2.00km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
10	TUNELI - Qendra e fshatit Restelicë - 3km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
b	RRUGA REGJIONALE DRAGASH – BROD (R114)				
11	Nga rruga kryesore Brod - -Qendra e fshatit Lubovishte 0.5km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
12	Nga rruga kryesore Brod - Qendra e fshatit Dikanc - 1.1km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
13	Nga rruga kryesore Brod - Qendra e fshatit Backe - 1.9km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
14	Qendra e fshatit Brod - 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
15	Brod - Qendra turistike 3.86km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
c	RRUGA REGJIONALE DRAGASH-ZAPLUXHE (R113) (R222)				
16	Nga rruga kryesore - Rapca e Eperme 3.54 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
17	Rapçë e poshtme - Qendra e fshatit Kersteci i Eperme - 3.9km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
18	QENDRA PETROL - Qendra e fshatit Rrenc - 2.2 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
19	Nga rruga kryesore - Qendra e fshatit Pllavë 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
20	Tyrbe - Qendra e fshatit Pllavë 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
21	Restoran DASMA - Qendra e fshatit Zym - 3.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
22	Qendra e fshatit Bellobrad - 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
23	Qendra e fshatit Buzez - 1.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
24	Udhekryqi Buzez-Kapre - 0.9 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
25	Udhekryqi Buzez-Kosavë - 1.7 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
26	Buzez - deri me Qendra e fshatit Kuk - 1.80 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
27	Qendra e fshatit Bresanë - 4.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
28	Kuklibeg - Kuk - 2.00km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
29	Zgatar-Blaq - 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
30	Zgatar-Bresanë-1.5 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
31	Qendra e fshatit Blaq - 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
32	Qendra e fshatit Zaplluxhe - 2.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
aa	RRUGA LOKALE DRAGASH – LUBOVISHT - LESHTAN-RADESHE				
33	Dragash-Libeviştë - 0.78km	km	1	€ 95.00	€ 95.00



34	Libevishtë - Leshtan - 2.42 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
35	Dragash-Radesh - 4.2 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
36	Radesh - Leshtan - 1.6 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
bb	RRUGA LOKALE DRAGASH - SHAJNE-XERXE - PLLAJNIK				
37	Dragash- Shajne, 1.25 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
38	Shajne- Xërxe - 3.35 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
39	Xerxe - Pllajnik - 4.30 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
40	Shajne-Qendra e Bisznisi - 3.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
cc	RRUGA LOKALE DRAGASH – BUQE - BREZNE-PLLAVE				
41	Llapushnik-Buhe 1.76 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
42	Llapushnik-Brezne 3.00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
43	TROKAN- Brezne - 2km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
dd	RRUGA LOKALE DRAGASH – BELLOBRAD – BRRUT - ZGATAR				
44	Bellobrad- Qendra e fshatit Brrut 2.2 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
45	Brrut- Zgatar 7.65 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
46	Brut-TROKAN - 4 .00 km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
ee	RRUGA LOKALE KOSAVE-PLAJNIK				
47	Kosavë - Pllajnik - 5.20km	km	1	€ 95.00	€ 95.00
48	Furnizimi me kripë,hudhja e rères dhe kripës në rrugët (një korsi ) te asfaltuara të rendit të IV ,sipas nevojes.	km	1	€ 95.00	€ 95.00
49	Pastrimi i trotoareve dhe qendres se qytetit nga bora si dhe transporti dhe largimi bores deri ne deponinme te aferte. ( QENDRA e DRAGASH)	km	1	€ 1,000.00	€ 1,000.00
<b>A - Gjithsej (1-49):</b>					<b>€ 5,560.00</b>

B	Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale	Njesia	Sasia	Çmimi njësi	Totali 40 % e pikeve ne vleresim
1	Hapja e kanaleve sipas nevojes për m'	m'	1	3.00	€ 3.00
2	Hapja e gropave lyrja me Emulsion , pwrgaditja dhe bushja me asfalt-beton t-7cm.	m <sup>2</sup>	1	25.00	€ 25.00
3	Furnizimi ,transporti,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit te rendit te IV me zhavor fr 030-060mm,sipas nevojes	m <sup>3</sup>	1	20.00	€ 20.00
4	Furnizimi ,transporti,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit te rendit te IV me material hedhurin, sipas nevojës	m <sup>3</sup>	1	15.00	€ 15.00
5	Furnizimi ,transporti,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit te rendit te IV me material 2,3,4. sipas nevojës.	m <sup>3</sup>	1	15.00	€ 15.00
6	Prerja e asfaltit sipas nevojës	m <sup>2</sup>	1	2.00	€ 2.00
7	Pastrimi i barit nëper bankinat e rrugëve, troatuareve	m <sup>2</sup>	1	1.00	€ 1.00
8	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e kubëzave me trashësi t=8 cm (te gjitha dizajnet)	m <sup>2</sup>	1	20.00	€ 20.00
9	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e kubëzave me trashësi t=6 cm (te gjitha dizajnet)	m <sup>2</sup>	1	18.00	€ 18.00
10	Pasrtimi i ujembledheseve	copë	1	1.00	€ 1.00
11	Largimi i borës nga rrugët (një korsi) e asfaltuara dhe hudhja e rères dhe kripes në rruget e asfaltuara dhe të rendit të IV ,sipas nevojes.	km	1	55.00	€ 55.00
12	Regullim dhe furnizimi me rrjeta metalike të knalizimit {kapak}	copë	1	1.00	€ 1.00



13	Vendosja e mbrojtëseve të metalit në urat dhe ngjyrës së rezistencës ndaj ujit për metal	m'	1	55.00	€ 55.00
14	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajorve 20cmX8cm X 60cm , nga betoni C40	m'	1	15.00	€ 15.00
15	Prerja e skajoreve ekzistuese, nivelizimi i skajoreve dhe trottuarit me asfalt etj.	m'	1	15.00	€ 15.00
16	Pastrimi i pusetave të kanalizimit atmosferik.	copë	1	5.00	€ 5.00
17	Rregullimi dhe furnizimi me puseta dhe rrjetë metalike me konus te kanalizimit), atmosferik .	copë	1	95.00	€ 95.00
18	Rregullimi dhe furnizimi me gypë Ø 1000 të betonit ( kanalizimit), atmosferik,gjatësi metër	copë	1	60.00	€ 60.00
19	Rregullimi dhe furnizimi me gypë Ø 800 të betonit me konus. (të kanalizimit, atmosferik)gjatësi metër	copë	1	50.00	€ 50.00
20	Rregullimi dhe furnizimi me rrjetë metalike(kapak)të kanalizimit atmosferik deri 40 tonë.	copë	1	70.00	€ 70.00
21	Kapak të betonit për puseta të betonit, Ø800,Ø600.	copë	1	15.00	€ 15.00
22	Elementet e betonit që shërbejn si murë mbrojtës nga rreshqitura e dheut ,1 m X 1.2m.	copë	1	74.00	€ 74.00
23	Varrosja e kafsheve të ngordhura,transportimi,ngarkim-shkarkimi	copë	1	1.00	€ 1.00
24	Pastrimi i rrugeve lokoleve nga zhavori dhe rrëshitja e dheut në rrugë etj .	m³	1	20.00	€ 20.00
25	Funizim me gyp Ø160mm i brinjëzuar për kanalizim atmosferik	m'	1	2.00	€ 2.00
26	Funizim me gyp Ø250mm i brinjëzuar për kanalizim atmosferik.	m'	1	5.20	€ 5.20
27	Pastrimi dhe formesimi i kanaleve egzistuese te prokave.	m'	1	1.00	€ 1.00
28	Beton MB30	m³	1	75.00	€ 75.00
29	Rrenim i objekteve dhe bartja e mbetjeve inerte deri në deponi komunale	h	1	25.00	€ 25.00
30	Furnizimi me uje,transporti si dhe pastrimi i rrugeve,shesheve te ndryshme te qytetit dhe fshatrave.	m²	1	3.00	€ 3.00
31	Kapak të betonit për puseta të betonit, Ø600.Ø800.Ø1000	copë	1	15.00	€ 15.00
32	Larja verore e rrugeve nga pluhuri ne Qytezen e Dragashit	km	1	250.00	€ 250.00
<b>B - gjithsejt (1-32) :</b>					<b>€ 1,027.20</b>

	çmimi total	çmimi total i peshuar
A - Gjithsej (1-49): ( 60 % e pikeve per vleresim)	€ 5,560.00	€ 3,336.00
B - gjithsejt (1-32) :( 40 % e pikeve ne vleresim)	€ 1,027.20	€ 410.88
Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresoohen ne baze te kesaj vlore). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.		
<b>TOTALI (100%) :</b>		<b>€ 3,746.88</b>

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.N.T.SH."DRINI COMPANY"sh.p.k
Emri dhe Mbiemri I Përfaqësuesit te OE	Fatmir Gashi
Nënshkrimi:	
Data:	15.10.2018
Vula:	

Specifikimet e hollësishme janë paraqitur në një fletë të veçantë excel, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj dosjeje të tenderit. Operatori ekonomik duhet te plotësoj dhe te dorëzoj dokumentin ne Excel. Çmimet duhet të vendosen me kompjuter. (Nuk lejohet plotësimi i çmimeve me laps) si dhe të vendosen në një (CD ose flesh) e cila duhet të dorëzohet së bashku me tenderin. Vlon vetëm për tenderët e dorëzuar në mënyrë fizike.

